20 Nëntor 2026

Njoftim mbi administrimin e njoftimeve kontraktore nëpërmjet aplikacionit "Abissnet"

I nderuar Pajtimtar,

Në zbatim të Ligjit nr. 54/2024 "Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë", Rregullores së AKEP-it nr. 49, datë 11.03.2021, si dhe pikave 2.2 dhe 14 të Kushteve të Përgjithshme të Kontratës së Pajtimit, Abissnet sh.a. ju njofton se, duke filluar nga data **01.01.2027** aplikacioni Abissnet do të përdoret si linjë zyrtare digjitale për komunikimin dhe administrimin e njoftimeve individuale që lidhen me marrëdhënien tuaj kontraktore.

Në seksionin "Njoftimet kontraktore" do të vendosen njoftimet që lidhen me kushtet e kontratës, çmimet, përmbajtjen e paketës, parametrat e cilësisë së shërbimit, kohëzgjatjen dhe përfundimin e kontratës, si dhe me çështje të tjera që prekin të drejtat dhe detyrimet tuaja si pajtimtar.

Çdo njoftim do të vendoset në llogarinë tuaj individuale në një formë që ju mundëson ta lexoni, shkarkoni, ruani dhe riprodhoni të pandryshuar për qëllime dokumentimi dhe konsultimi të mëvonshëm.

Në varësi të natyrës dhe rëndësisë së njoftimit, si dhe kur kërkohet nga legjislacioni ose kushtet e kontratës, Abissnet do të përdorë edhe SMS-in, email-in ose një mjet tjetër komunikimi të regjistruar.

Kur njoftimi përmban një ndryshim të propozuar të kushteve kontraktore, ai do të përcaktojë në mënyrë të qartë përmbajtjen e ndryshimit dhe datën e hyrjes së tij në fuqi. Njoftimi do të kryhet brenda afatit ligjor dhe, kur kjo e drejtë zbatohet, do t'ju informojë edhe për mundësinë e zgjidhjes së kontratës pa kosto shtesë, së bashku me afatin dhe mënyrën e ushtrimit të kësaj të drejte.

Për të pasur akses në njoftimet tuaja kontraktore, ju lutemi të shkarkoni ose të përditësoni aplikacionin Abissnet nëpërmjet adresës:

https://abissnet.al/aplikacioni

Ju lutemi të verifikoni gjithashtu që numri celular dhe adresa e email-it të regjistruar pranë Abissnet janë të sakta dhe të përditësuara, si dhe të njoftoni Abissnet për çdo ndryshim të tyre, në përputhje me Kontratën e Pajtimit.

Nëse nuk dispononi pajisjen ose mundësinë teknike për përdorimin e aplikacionit, keni nevoja të veçanta aksesueshmërie ose nuk mund ta përdorni atë për një shkak tjetër të arsyeshem, mund të kërkoni pa pagesë marrjen e njoftimeve nëpërmjet një mjeti tjetër

ABISSNET sh.a. (Albanian Business Internet Service Solution Network)
Rr. "Ismail Qemali". Tiranë - Shqipëri. Tel: +355 44 300 123
sales@abissnet.al/www.abissnet.al

të qëndrueshëm. Kërkesa mund të paraqitet në numrin **044 300 001**, në adresën **support@abissnet.al** ose pranë çdo njësie Abissnet Store.

Ky njoftim ka karakter informues dhe administrativ dhe konkretizon përdorimin e një prej mjeteve të qëndrueshme të komunikimit të parashikuara në Kontratën e Pajtimit. Ai nuk sjell ndryshim të çmimit, përmbajtjes, cilësisë ose kohëzgjatjes së shërbimeve tuaja dhe nuk kufizon asnjë të drejtë që ju njihet nga ligji ose kontrata.

Shkarkimi dhe përdorimi i aplikacionit nuk përbën pranim paraprak të ndryshimeve të ardhshme kontraktore. Çdo ndryshim i tillë do t'ju njoftohet veçmas, duke respektuar përmbajtjen, procedurën dhe afatet e përcaktuara nga legjislacioni në fuqi dhe Kontrata e Pajtimit.

Për informacion mbi përpunimin e të dhënave personale gjatë përdorimit të aplikacionit, mund të konsultoni Njoftimin e Privatësisë në:

https://abissnet.al/ligjore/privatesia-e-aplikacionit

Ju falënderojmë për besimin dhe bashkëpunimin.

Abissnet sh.a.